



UNMIK/RREG/2001/31
29 tetor 2001

REGULLORE NR. 2001/31

**NDRYSHIMI I RREGULLORES 2000/67 MBI MIRATIMIN E BUXHETIT TË
KONSOLIDUAR TË KOSOVËS DHE AUTORIZIMIN E SHPENZIMEVE PËR
PERIUDHËN PREJ 1 JANARIT DERI MË 31 DHJETOR 2001**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Duke marrë parasysh Rregulloren e ndryshuar nr. 1999/1 të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) të datës 25 korrik 1999 mbi Autoritetin e Administratës së Përkohshme në Kosovë, Rregulloren nr. 2001/9 të 15 majit 2001 mbi Kornizën Kushtetuese të Qeverisjes së Përkohshme në Kosovë dhe Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/19 të 13 shtatorit 2001 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë,

Pas shpalljes së Rregullores së UNMIK-ut 2000/67 të datës 29 dhjetor 2000 mbi Miratimin e Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës dhe Autorizimin e Shpenzimeve për periudhën prej 1 janarit deri më 31 dhjetor 2001,

Me qëllim të bërjes së ndryshimeve të nevojshme në Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/67,

Me anë të të kësaj Rregullore ndryshohen nenet 1, 7, 9 dhe 11 dhe tabelat 1 e 2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/67.

Rrjedhimisht, kjo Rregullore nga data kur hyn në fuqi do të duket si vijon .

RREGULLORE NR. 2000/67

**PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË KONSOLIDUAR TË KOSOVËS DHE
AUTORIZIMIN E SHPENZIMEVE PËR PERIUDHËN PREJ 1 JANARIT DERI MË
31 DHJETOR 2001**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Duke marrë parasysh Rregulloren e Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) nr. 1999/1 të datës 25 korrik 1999, të ndryshuar, mbi Autoritetin e Administratës së Përkohshme në Kosovë dhe Rregulloren nr. 2000/16 të datës 6 nëntor 1999, të ndryshuar, mbi themelimin Autoritetit Qendror Fiskal dhe çështje të tjera lidhur me të,

Me qëllim të miratimit të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës për periudhën prej 1 janarit deri më 31 dhjetor 2001 dhe çështje të tjera lidhur me të

Shpall sa vijon:

Neni 1 Përkufizime

1.1. Sipas kësaj Rregulloreje:

(a) Me “linjë buxheti” nënkuptojmë kategoritë e përgjithshme të shpenzimeve për një departament të caktuar administrativ, njësinë e departamentit apo komunën;

(b) Me “kategoritë e shpenzimeve” nënkuptojmë rrogat dhe pagat, mallrat tjera dhe shërbimet, subvencionet dhe transferet, shpenzimet e kapitalit dhe shërbimet;

(c) Me “Mbajtje të llogarive të Autoritetit Qendror Fiskal” nënkuptojmë mbajtjen e llogarive të përcaktuara nga Autoriteti Qendror Fiskal;

(ç) Me “Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës” nënkuptojmë buxhetin e gjithëmbarshtëm të Kosovës, që përfshin transaksionet buxhetore të veprimtarisë së përgjithshme për sektorët e përgjithshëm administrativë, komunalë dhe për ndërmarrjet komunale e publike të veprimtarisë qeveritare, të konsoliduar në përputhje me standardet e pranura ndërkombëtare të financave;

(d) Me “Fondin e Konsoliduar të Kosovës” nënkuptojmë fondin e krijuar në përputhje me Rregulloren e ndryshuar të UNMIK-ut nr. 1999/16;

(dh) Me “Sektorin e Buxhetit të Përgjithshëm të Kosovës” nënkuptojmë atë pjesë të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës që përfshin transaksionet buxhetore të departamenteve administrative dhe të njësive të ngjashme sektoriale apo të agjencive;

(e) Me “Sektorin e Buxheteve Komunale të Kosovës” nënkuptojmë atë sektor të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës që përfshin transaksionet buxhetore të administratave të themeluara komunale të Kosovës dhe

(ë) Me “Deklaratat e shpenzimeve dhe të hyrave të ndërmarrjeve publike të Kosovës” nënkuptojmë atë sektor të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës që përfshin shpenzimet dhe të hyrat e ndërmarrjeve të caktuara publike të Kosovës ose të grupeve të ndërmarrjeve.

1.2 Referencat lidhur me Departament(in)et në këtë Rregullore nënkuptohen se i referohen organeve administrative përkatëse të pranuar nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm me qëllim të arritjes së marrëveshjeve kalmitare në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/19.

1.3 Referencat lidhur me bashkëkryesuesit e Autoritetit Qendror Fiskal, Departamentit Administrativ të Shërbimeve Publike dhe Departamentit Administrativ të Administratës Lokale në këtë Rregullore nënkuptohen se i referohen zyrtarëve kryesorë përgjegjës për organet përkatëse kalimtare administrative të referuara në nenin 1.2.

Neni 2

Shpenzimet e përgjithshme të autorizuara

Shpenzimet nga pjesa e Buxhetit të Përgjithshëm të Kosovës për qëllime të përgjithshme shtetërore autorizohen për periudhën prej 1 janarit deri më 31 dhjetor 2001 shumat e të cilave janë paraqitur në tabelën 1 që i është bashkëngjitur kësaj Rregulloreje.

Neni 3

Shpenzimet e autorizuara komunale

Shpenzimet autorizohen për periudhën prej 1 janarit deri më 31 dhjetor 2001 nga Sektori i Buxheteve Komunale të Kosovës për qëllimet e theksuara dhe shumat e paraqitura në tabelën 2 të kësaj Rregulloreje.

Neni 4

Shpenzimet dhe të hyrat e ndërmarrjeve publike

Shpenzimet dhe të hyrat e parashikuara për periudhën prej 1 janarit deri më 31 dhjetor 2001 nga deklaratimet e ndërmarrjeve publike të Kosovës për shpenzimet dhe të hyrat e theksuara janë paraqitur në tabelën nr. 3 që i është bashkëngjitur kësaj Rregulloreje. Shpenzimet e parashikuara në tabelën nr. 3 autorizohen vetëm për të hyrat e realizuara të çdo ndërmarrjeje, duke përfshirë të hyrat në formë të subvencioneve që janë përfshirë në tabelën 1.

Neni 5

Rindarja e detyrimeve financiare të pashpenzuara dhe bilancet

5.1. Pas përfundimit të vitit financiar 2000, bashkëkryesuesi i Autoritetit Qendror Fiskal i dorëzon Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm një pasqyrë të detyrimeve të pashpenzuara financiare për vitin 2000, të regjistruara siç duhet në librin e llogarive të Autoritetit Qendror Fiskal dhe i rekomandon miratimin e kategorive dhe shumave të detyrimeve të tilla financiare të pashpenzuara. Pas miratimit nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm, shpenzimet për detyrimet e tilla konsiderohen të autorizuara për periudhën prej 1 janarit deri më 31 dhjetor 2001 nga Fondi i Konsoliduar i Kosovës për qëllime të përgjithshme qeveritare.

5.2. Shpenzimet nga bilancet e pashpenzuara të dhurimeve të donatorëve të caktuar, dhurime të cilat në të vërtetë janë pranuar në vitin 1999 dhe 2000, do të autorizohen për

periudhën prej 1 janarit deri më 31 dhjetor 2001. Nëse qëllimi i specifikuar nuk është përfshirë në tabelat e kësaj Rregulloreje, një shumë ekuivalente e bilancit të pashpenzuar të dhurimit të një donatori të caktuar konsiderohet se është ndarë dhe është krijuar linja buxhetore për të lejuar realizimin e shpenzimeve.

Neni 6 Kufizimet në shpenzime

6.1. Në pajtim me nenin 4.4 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/16 nuk mund të bëhen kurrfarë shpenzimesh apo detyrimesh financiare nga Fondi i Konsoliduar i Kosovës ose në dëm të tij, pos autorizimeve të saktësuara me këtë Rregullore. Pavarësisht nga ky kufizim, dhurimet e papritura të donatorëve, të depozituara në Fondin e Konsoliduar të Kosovës për qëllime të caktuara, mund të ndahen dhe të shpenzohen për ato qëllime. Nëse qëllimi i specifikuar nuk është përfshirë tani në tabelat e kësaj Rregulloreje, një shumë ekuivalente me dhurimin e depozituar të donatorit mund të ndahet dhe të krijohet linja e buxhetit për të lejuar realizimin e shpenzimeve.

6.2. Të hyrat nga participimi dhe pagesat e mbledhura nga Departamenti i Shëndetësisë dhe i Mirëqenies Sociale në vitin 2001, gjer në shumën prej 12.000.000 DM do të ndahen sapo të pranohen të hyrat. Për të hyrat e mbledhura mbi shumën prej 12.000.000 DM bashkëdrejtuesi i Autoritetit Qendror Fiskal si dhe bashkëkryesuesit e Departamentit Administrativ të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale i rekomandojnë Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm për mënyrën e ndarjes të atyre të hyrave.

6.2 Departamentet administrative dhe komunat kujdesen që shpenzimet për rroga dhe paga të mos i tejkalojnë shumat e paraqitura në tabelat 1 dhe 2 dhe se numri i personelit të punësuar në fund të vitit 2001 të mos e tejkalojë numrin e saktësuar në tabelat 1 dhe 2. Çdo propozim i mëvonshëm për rritjen e shpenzimeve për rroga dhe paga apo për numrin e të punësuarve mund të miratohet vetëm nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm, duke marrë parasysh mendimet e bashkëkruesuesit të Autoritetit Qendror Fiskal dhe të bashkëkryesuesve të departamenteve të shërbimeve publike, e në rastet kur kemi të bëjmë me komunat merret parasysh mendimi i administratave lokale.

Neni 7 Shpenzimet e jashtëzakonshme

7.1 Shumat e autorizuar për shpenzimet e jashtëzakonshme mund të përdoren vetëm për kërkesat urgjente apo për qëllime të paparapara, ose për qëllime që kanë të bëjnë me zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/9 dhe marrëveshjet e ngjashme kalimtare të referuara në Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/19. Bashkëkryesuesi i Autoritetit Qendror Fiskal mund të autorizojë, pas marrjes së arsyetimit të duhur dhe prej rastit në rast, shpenzime deri në 100.000 DM për qëllimet e përfshira në këtë nen. Propozimet për shpenzimin e shumave mbi 100.000 DM do i dërgohen për autorizim Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm, bashkë me rekomandimin e bashkëkryesuesit të Autoritetit Qendror Fiskal.

7.2. Komunat ua paraqesin për shqyrtim propozimet e tyre për shpenzime të jashtëzakonshme bashkëkryesuesve të Departamentit Administrativ të Administratës Lokale. Bashkëkryesuesit e Departamentit Administrativ të Administratës Lokale i rekomandojnë bashkëkryesuesit të Autoritetit Qendror Fiskal për pranimin apo shqyrtimin e opcioneve të tjera, duke përfshirë transferimet financiare të autorizuar me nenet 8.1 dhe 9 të mëposhtëm.

Neni 8
Përshtatja e shumave të autorizuara

8.1. Bashkëkryesuesi i Autoritetit Qendror Fiskal mund të transferojë shuma të autorizuara ndërmjet destinimeve për kategoritë e shpenzimeve të çfarëdo linje individuale buxhetore në tabelën 1 dhe 2, me kusht që shuma totale mos t'i tejkalojë njëzet e pesë për qind (25%) të kategorisë e cila zvogëlohet. Transferimet mbi këtë limit, duke përfshirë transferimet ndërmjet linjave buxhetore në tabelën 1, mund të bëhen pas miratimit me shkrim të Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm, duke marrë parasysh mendimin e bashkëkryesuesit të Autoritetit Qendror Fiskal. Destinimet për rezerva mund të transferohen pjesërisht ose në tërësi në cilëndo kategori për të njëjtin funksion me miratimitin e bashkëkryesuesit të Autoritetit Qendror Fiskal.

8.2. Bashkëkryesuesi i Autoritetit Qendror Fiskal mund t'i transferojë shumat e autorizuara në pajtim me nenin 7 të mësipërm ndërmjet linjave buxhetore në tabelat 1 dhe 2.

Neni 9
Rregullimi i shumave të buxhetit komunal

Me kërkesë të zëvendësit të Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm për Administratë Civile, bashkëkryesuesi i Autoritetit Qendror Fiskal mund të transferojë shuma financiare prej një komune në një komunë tjetër, me kusht që destinimi i përgjithshëm për buxhetet komunale të Kosovës të mos ndërrojë. Nëse mbledhja aktuale e burimeve të mëvetësishme të të hyrave të cilësdo komunë e tejkalon shumën e paraqitur në tabelën 2, pesëdhjetë për qind (50%) të asaj shume konsiderohen si mjete të ndara dhe, në bazë të kërkesës së ndonjë komune e cila është miratuar më parë nga bashkëkryesuesit e Departamentit Administrativ për Administratë Lokale, bashkëkryesuesi i Autoritetit Qendror Fiskal i ndan ato shuma për shpenzime. Mbetja tjetër prej pesëdhjetë për qind (50%) depozitohet në Fondin e Konsoliduar të Kosovës dhe përveç shërbimeve komunale mund të shfrytëzohet edhe për qëllime të tjera pas miratimit nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.

Neni 10
Shpenzimet e kufizuara në të ardhurat

Bashkëkryesuesi i Autoritetit Qendror Fiskal, me rastin e ndarjes së fondeve për shpenzime, i ndan vetëm ato mjete financiare për aq sa të hyrat apo burimet tjera financiare janë në dispozicion të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës për t'i bërë ato shpenzime.

Neni 11
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore¹ hyn në fuqi më 29 tetor 2001.

Hans Haekkerup,
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm

¹ Rregullorja origjinale ka hyrë në fuqi më 29 dhjetor 2001.

